



## Raporti mujor mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore - gusht 2017 -

### I GJYQËSORI

#### Pavarësia

##### **Dorëheqja e kryetarit të Këshillit të Prokurorëve Publikë, Petar Anevski**

Z. Petar Anevski dha dorëheqje nga pozita e kryetarit të Këshillit të Prokurorëve Publikë për arsye familjare dhe personale. Ai për herë të parë në këtë funksion është emëruar në vitin 2014, kurse për herë të dytë është zgjedhur në shtator të vitit 2016. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut atëherë reagoi sepse ligji nuk lejon rizgjedhje. Megjithatë, z. Anevski atëherë e ka interpretuar ligjin se mandati i dytë si anëtar i këshillit i lejon rizgjedhje. Anevski deklaroi se tërhiqet për arsye personale. Në të njëjtën seancë për u.d. Prokuror i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë, Këshilli e zgjodhi Liljana Spasovska, zëvendëse e ish-prokurorit të përgjithshëm z. Marko Zverlevski.<sup>1</sup>

##### **U merret imuniteti gjykatësve të akuzuar në rastin “Titanik 2”**

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në seancën 261 mori vendim për marrje të imunitetit të pesë gjykatës të Gjykatës Administrative të akuzuar në “Titanik 2”, lëndë të cilën e ka PSP-ja për parregullsitë në zgjedhje për zgjedhjet lokale në vitin 2013.

Nga Këshilli Gjyqësor informuan se janë marrë vendime edhe për përfundim të funksionit gjyqësor të Abdulla Limanit, gjykatës në Gjykatën e Apelit Shkup dhe të Jagotka Denkovskës, gjykatëse në Gjykatën Themelore Kumanovë, sepse kanë mbushur 64 vjet.<sup>2</sup>

<sup>1</sup><http://telma.com.mk/vesti/anevski-podnese-ostavka-od-lichni-prichini>

<sup>2</sup>[http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/ab9c85ab-4e0c-4a33-92cd-63179dbaf8c4!/ut/p/z1/tZNbT8lwGIZ\\_Cxe7bNpt3dpeTmUQ5CDBcesN6bYOKu4A1Hn49ZbExAARNghvmibv93zvdvjkcAZ5KRq1EFpVpXgy75j7c7-DMaK3qE97NwwFEXbD8d29jQmG031Bxx5RIxhFPuuGThS5kJ-Of4Ac8rTUv7CeFs1Us-LIYW2z5mF6iqVuhQWauRWkwJhKXUEwnAEqUAC9cFzEkz4Ls2YVvicpriHa5OVQZjiROWYw8D7DAKcM4IELbrA0ySlOaEOVnGDu0f-9vZR9-cAH3GnxDwc-3j51LwfcZxh2PjgXwJRt2QGEHb9gl6diZdY7JR8gVGZbUpzEgnv2yRARxkOCgitC\\_McBo\\_9P4XTy7E987N2Pwh9bhe88AselVq-arh7C823XCdzeB6sDB2hV4CveYVnP0otC6igrpvCqzyQdvFca95vxqC3dWX06DV-gCWRYHn/dz/d5/L2dBISevZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fsovet\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fa b9c85ab-4e0c-4a33-92cd-63179dbaf8c4](http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/ab9c85ab-4e0c-4a33-92cd-63179dbaf8c4!/ut/p/z1/tZNbT8lwGIZ_Cxe7bNpt3dpeTmUQ5CDBcesN6bYOKu4A1Hn49ZbExAARNghvmibv93zvdvjkcAZ5KRq1EFpVpXgy75j7c7-DMaK3qE97NwwFEXbD8d29jQmG031Bxx5RIxhFPuuGThS5kJ-Of4Ac8rTUv7CeFs1Us-LIYW2z5mF6iqVuhQWauRWkwJhKXUEwnAEqUAC9cFzEkz4Ls2YVvicpriHa5OVQZjiROWYw8D7DAKcM4IELbrA0ySlOaEOVnGDu0f-9vZR9-cAH3GnxDwc-3j51LwfcZxh2PjgXwJRt2QGEHb9gl6diZdY7JR8gVGZbUpzEgnv2yRARxkOCgitC_McBo_9P4XTy7E987N2Pwh9bhe88AselVq-arh7C823XCdzeB6sDB2hV4CveYVnP0otC6igrpvCqzyQdvFca95vxqC3dWX06DV-gCWRYHn/dz/d5/L2dBISevZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fsovet_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2Fa b9c85ab-4e0c-4a33-92cd-63179dbaf8c4)



## Paanësia

### **Gjykata e Apelit në Shkup mori vendim për pranimin e “bombave” si dëshmi në procedurën penale – Gjykata e Lartë edhe përkrah kësaj do të diskutojë se a do të përdoren ato si dëshmi**

Gjykata e Apelit Shkup më 4 gusht 2017 mori vendim me të cilin e pranoi ankesën e Prokurorisë Publike për Ndjekje të Veprave Penale që Lidhen dhe Dalin nga Përmbajtja e Ndjekjes Joligjore të Komunikimeve Shkup dhe e rrëzoi vendimin e marrë nga Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup me të cilin shkresat e lëndëve janë veçuar nga materialet e xhiruara të propozuara si dëshmi për lëndën lidhur me ngjarjet në Komunën Qendër.

Në përputhje me këtë vendim dëshmitë e marra nga materialet e përgjuara mund të përdoren si dëshmi në procedurën penale.<sup>3</sup>

Me këtë vendim Apeli praktikisht ka lejuar që bombat të trajtohen si dëshmi në procedurën penale, që Gjykata Themelore Shkup 1 i ka rrëzuar në dhjetor të vitit 2016.

### **Gjykata e Lartë do të diskutojë a do të përdoren “bombat” si dëshmi dhe përkrah vendimit të Apelit të Shkupit**

Megjithatë, mbetet të shihet si do të veprojë mandej Gjykata e Lartë pas deklarates së Kryetarit të saj, Jovo Vangelovski, i cili mbetet në idenë për diskutim sipas referatit të dhënë nga ai me qëllim që Gjykata e Lartë të japë mendim të drejtë parimor për faktin se a mund të përdoren “bombat” e opozitës si dëshmi në procedurën e gjykatës. Vangelovski deklaroi se deklarimi i Gjykatës së Apelit në Shkup për veçimin e dëshmimeve në rastin “Dhunë” në Komunën Qendër lidhe vetëm me një lëndë konkrete, sepse bëhet fjalë për vendim ndërprerës, dhe jo për vendim meritior.

Vangelovski theksoi se seanca e përgjithshme e Gjykatës së Lartë diskutoi në përgjithësi për pyetjen juridike, kurse jo për rastin konkret, por do të ketë parasysh edhe vendimin e Apelit të Shkupit. Për vazhdimin e seancës publiku do të informohet së shpejti.

Si rikujtim, gjykatësja e deritanishme në Gjykatën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e njeriut në Strazburg, Mirjana LLazarova-Trajkovska, e cila ishte ftuar nga kryetari i Gjykatës, Jovo Vangelovski, gjykatësve të lartë në maj të vitit 2017 u shpërndau 35 ekzemplarë nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut sipas të cilave, materialet e marra në mënyrë jolegale mund të konsiderohen si

<sup>3</sup>[http://www.vsrn.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti/6e2965c9-7142-4157-b2f9-0b35e4d3fdc5!/ut/p/z1/rVLLUsJAEPwWDzmGHfLG20rxMEJRCgJZC5XH5qHJbkiWRP6l JgSSlg4d5mq7tnumcQQWtEmN9kiS8yzvxc1h6xNtbIMMB5glkzf7oDPADbWfQwwMBGq1OAORAQOc1 RgSRkilSpMgrd0GehZviVYF6FylQ8pAKSi vQ0FpkClhU61lm2FPtrqGpRte01UCLeyoEukmNSI-i0DzoiWEWle8i9Oqcwcp88MvDIPnkHMRfJMI58JkmZoHuJlhUNKYVrTq7Sn6nQpT1rQIKtG3bSThPctoJeaHAT5SU1wKtvYORJ33YXz5m46ENeDnomth51GZYLqrJaluWjFeFnGT-x5jGcNzhKCnXvLLDSfn5vXWlvHvuEGXQWjXtT2XQpS9SNWmXR-uLtCU1e9luCZaXzJmgb3I9\\_3LKZbEsHH2vsvcjXame27Tli76gbPX8wTf3HwAnllTkg!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic\\_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F6e2965c9-7142-4157-b2f9-0b35e4d3fdc5](http://www.vsrn.mk/wps/portal/asskopje/sud/vesti/6e2965c9-7142-4157-b2f9-0b35e4d3fdc5!/ut/p/z1/rVLLUsJAEPwWDzmGHfLG20rxMEJRCgJZC5XH5qHJbkiWRP6l JgSSlg4d5mq7tnumcQQWtEmN9kiS8yzvxc1h6xNtbIMMB5glkzf7oDPADbWfQwwMBGq1OAORAQOc1 RgSRkilSpMgrd0GehZviVYF6FylQ8pAKSi vQ0FpkClhU61lm2FPtrqGpRte01UCLeyoEukmNSI-i0DzoiWEWle8i9Oqcwcp88MvDIPnkHMRfJMI58JkmZoHuJlhUNKYVrTq7Sn6nQpT1rQIKtG3bSThPctoJeaHAT5SU1wKtvYORJ33YXz5m46ENeDnomth51GZYLqrJaluWjFeFnGT-x5jGcNzhKCnXvLLDSfn5vXWlvHvuEGXQWjXtT2XQpS9SNWmXR-uLtCU1e9luCZaXzJmgb3I9_3LKZbEsHH2vsvcjXame27Tli76gbPX8wTf3HwAnllTkg!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F6e2965c9-7142-4157-b2f9-0b35e4d3fdc5)



dëshmi në procedurat gjyqësore. “Gjykata nuk mund të marrë rolin e ligjvënësit dhe ajo ta rregullojë atë materie, ndërsa duhet të lejojë individualizmin në çdo rast”, tha atëherë Llazarova-Trajkovska.<sup>4</sup>

## **Përgjegjësia**

### **U shkarkua ish-prokurori publik z. Marko Zvërlevski**

Më 17 gusht 2017 është shkarkuar prokurori publik z. Marko Zvërlevski, pas votimit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me shumicë votash “PËR” dhe në mungesë të opozitës parlamentare të udhëhequr nga VMRO DPMNE. Menjëherë pas kësaj me propozim të Qeverisë është dorëzuar kërkesë në Kuvend që të shpallet shpallje për prokuror të ri publik. Ishte e qartë që u.d. Prokuror publik i RM-së, i cili do të ushtrojë përkohësisht këtë funksion deri në zgjedhjen e prokurorit të ri publik do të zgjidhet nga radhët e prokurorëve të tanishëm publikë në prokurori. Edhe pse Këshilli i Prokurorëve Publikë të RM-së duhej të emëronte u.d. Prokuror publik, pikërisht para seancës ku duhej të zgjidhej u.d. Prokuror publik, kryetari i Këshillit dha dorëheqje nga funksioni. Dorëheqja e z. Anevski nuk ishte pengesë që të emërohej znj. Liljana Spasovska si u.d. Prokuror publik i Republikës. Prokurorja Spasovska është e njohur për publikun për rastin “Monstrum” kur ajo ishte prokurore publike në diskutimin publik që u mbajt me ankesë të të akuzuarve në këtë rast, të dënuar me burg të përjetshëm. Ajo kërkoi atëherë shtyrje të seancës së ardhshme derisa të mblidhen të gjitha faktet dhe dëshmitë të cilat i posedon Prokuroria Speciale Publike.<sup>5</sup>

### **Fletëparaqitje penale për Jovo Vangellovskin dhe gjykatësit për lëndën “Kështjella”**

Shoqata “Zelena Ilupa” ka dorëzuar fletëparaqitje penale në Prokurorinë Publike për Ndjekje të Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar, si dhe iniciativat për ngritje të përgjegjësisë te Këshilli për Përcaktim të Fakteve, të cilat kanë të bëjnë me gjykatësit për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara se kanë lejuar ikjen e të akuzuarve Goran Grujovski dhe Nikolla Boshkovski.

Përveç fletëparaqitjeve për gjykatësit që ishin të obliguar ta udhëheqin rastin “Kështjella” fletëparaqitje penale janë ngritur edhe kundër gjykatësve Lenka Davitkovska, Tatjana Mihajlova dhe Dijana Gruevska nga Gjykata Themelore Shkup 1, Liljana Shopova, Safet Kadriu dhe Cvetanka Periq nga Gjykata e Apelit Shkup dhe kundër gjykatësve Jovo Vangellovski, Faik Arsllani, Risto Katavenoski dhe Xhemail Saiti nga Gjykata e Lartë. Sipas kësaj Shoqate të gjitha fletëparaqitjet lidhen me keqpërdorimin e pozitës zyrtare me qëllim që të kenë fitim.<sup>6</sup>

## **Profesionalizmi, efikasiteti profesional**

### **Është ngritur aktakuzë kundër personit i cili e sulmoi Radmilla Sheqerinskën në Kuvend**

Prokuroria Themelore Publike – Shkup, në lidhje me ngjarjet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill 2017, informoi se është ngritur procedurë hetimore kundër një personi për veprën penale të

<sup>4</sup><http://makfax.com.mk/daily-news/вангеловски-не-се-откажува-и-покрај-од/>

<sup>5</sup><http://www.pravdiko.mk/obvinitelkata-liljana-spasovska-ke-go-menuva-zvrlevski-do-izborite/>

<sup>6</sup><http://a1on.mk/archives/775355>



kryer Dhunë nga neni 386 paragrafi 6, kurse në lidhje me paragrafët 3 dhe 1 të Kodit Penal, për të cilën në përputhje me paragrafin 6, parashikohet dënimi me burg nga 3 deri në 10 muaj.

PTHP informoi se pas procedurës hetimore të përfunduar, në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup është dorëzuar edhe aktakuza kundër të akuzuarit me të cilin ai akuzohet se në ngjarjet në shtëpinë ligjvënëse ka kryer dhunë të ashpër, duke e tërhequr për flokësh znj. Radmilla Sheqerinskën, deputete në Kuvendin e Maqedonisë. E dëmtuara në këtë ngjarje ka pësuar lëndim të rëndë trupor.

Kjo aktakuzë vjen pas një kohe kur shumica e personave të cilët kanë marrë pjesë në ngjarje tashmë kanë marrë përfundim gjyqësor.<sup>7</sup>

### **Zgjerohet hetimi për “Të enjten e përgjakshme”**

Prokuroria për Krimin e Organizuar e cila e udhëheq hetimin për “E enjtja e përgjakur” më 27 prill do ta zgjerojë hetimin në drejtim të përcaktimit se a kanë qenë pjesë e organizimit të ngjarjeve në Kuvend kundërzbuluesi serb, Goran Zhivaleviq dhe këshilltari për siguri i kryetarit Sinisha Aleksovski.

Kjo është përcaktuar edhe nga prokurorja Vilma Ruskovska, e cila ishte pjesë e ekipit të prokurorëve të cilët e udhëhoqën hetimin, e cila shtoi se këto janë indikacionet e para të cilat mund edhe të përcaktohen por mund edhe të mos dëshmohen. Sipas saj, “vetë prania e Zhivaleviq në Kuvend është skandal diplomatik, por edhe vepër penale pjesëmarrje në turmë”.

Zgjerimi i hetimit është përshëndetur nga Kabineti i Ivanovit me vërejtjen se presin “përgjigje nga prokuroria mbi rolin e z. Zhivaleviq në ngjarjet në Kuvend. Publiku duhet të dijë kush e ka dërguar, çfarë ka ndërmarrë, me kë ka qenë dhe a ka pasur miratim nga organi kompetent shtetëror që të hyjë në Kuvend në ditën kritike.”<sup>8</sup>

### **U mbajt takimi i dytë i Këshillit për Reforma në Gjyqësor dhe takimi i punës për përgatitjen e Strategjisë**

Në Ministrinë e Drejtësisë u mbajt takimi i dytë i Këshillit për Reforma në Gjyqësor, ku ishin të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Propozim-strategjia për reforma në sektorin gjyqësor ishte prezantuar nga kryetarja e grupit të punës, prof. dr. Ana Pavlovska-Daneva, kurse Ministri i drejtësisë u bëri thirrje anëtarëve të Këshillit që t’i japin mendimet dhe vërejtjet e veta. Propozim-strategjia është përshëndetur si një dokument i mirë strategjik, ku janë shënuar shumica e dobësive në sistemin e gjyqësorit me propozim-masa konkrete.

Në këtë takim është shpërndarë edhe propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Këshillit Gjyqësor në RM dhe Ligjit për shfuqizim të Ligjit për Këshillin për Përcaktim të Fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë të gjykatësit për të cilat është paralajmëruar se Këshilli do të informojë në seancën e ardhshme.<sup>9</sup>

<sup>7</sup><http://jorm.gov.mk/?p=4184>

<sup>8</sup><http://vesti.mk/read/news/13922563/4802161/istraga-za-zhivaljevikj-i-aleksovski>

<sup>9</sup>[http://www.justice.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1381](http://www.justice.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1381)



Më 29 gusht 2017 u mbajt takimi i punës për përgatitjen e Strategjisë. Kryetarja e grupit të punës, prof. dr. Pavlovska-Daneva, e prezantoi shkurtimisht Propozim-strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit, duke thënë se gjatë përgatitjes janë marrë parasysh shënimet dhe propozimet e anëtarëve të grupit të punës, të dorëzuara në fazën e hershme të përgatitjes. Gjithashtu është theksuar se një pjesë e këtyre vërejtjeve janë vendosur në Propozim-strategjinë dhe në Planin aksionar, kurse një pjesë e tyre janë vendosur në zgjidhjet e ardhshme ligjore.

Pjesëmarrësit i kanë mbështetur zgjidhjet e propozuara dhe kanë dhënë edhe sugjerime dhe propozime shtesë për përmbajtjen e propozim-strategjisë.<sup>10</sup>

## PROCEDURA GJYQËSORE AKTUALE

“Lagjja e trimave” - KOK 127/15

Në seancën e 30 gushtit 2017 për rastin “Lagjja e trimave” ka vazhduar me dhënien e fjalëve përfunduese nga mbrojtja. Ata në fjalët e veta përfunduese theksuan se është përcaktuar në mënyrë të pakontestueshme se të akuzuarit nuk e kanë kryer veprën.

Në seancën në vijim më 31.08.2017 u vazhdua me fjalët përfunduese nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre. Fjalë përfunduese dhanë tetë të akuzuar gjithsej. Gjykata i informoi të pranishmit se termet në vijim në shtator janë përcaktuar për më 12, 14, 18, 20, 22, 26 dhe 28 shtator 2016.

“ERAZMUS” – KOK 115/16

Gjykimi më 29 gusht 2017 ishte i mbyllur për publikun, sepse merrej në pyetje dëshmitari i mbrojtur. Njëkohësisht, seanca është shtyrë për muajin shtator.

## II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

### **Komisioni kundër korrupsionit ka ngritur procedura për përgjegjësi disiplinore, suspendim dhe dorëheqje pas shpalljes së zgjedhjeve**

Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK) në seancën e mbajtur më 29 gusht 2017 vendosi njëzëri të ngrejë procedura për tri ankesa kundër Sekretariatit të Përgjithshëm në Qeveri dhe Agjencisë së Punësimit të Qytetit Shkup për vendosjen e procedurave disiplinore, suspendim dhe dorëheqje pas shpalljes së zgjedhjeve.

Komisioni në tri raste ka konstatuar se ekziston bazë për zbatim të procedurave prandaj paralajmëroi se do të dorëzojë kërkesa te Sekretariati i Përgjithshëm dhe tek Agjencia e Punësimit që t’u dorëzohet dokumentacioni përkatës, siç tha kryetari Igor Tanturovski, për një kohë sa më të shpejtë, kurse

<sup>10</sup>[http://www.justice.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1382](http://www.justice.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1382)



maksimum për 15 ditë. Sipas tij, tridhjetë e dy të punësuar në Qeveri kanë dorëzuar ankesë kundër Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë.<sup>11</sup>

### **Sipas Komisionit të Antikorrupsionit, shkarkimi i Zvërlevskit është i paligjshëm**

Në seancën e mbajtur më 15 gusht 2017, Komisioni Shtetëror për Ndalim të Korrupsionit mori qëndrim se përfundimi i marrëdhënies së punës së prokurorit publik, Marko Zvërlevski është i paligjshëm, duke pasur parasysh se gjatë zgjedhjeve, në këtë rast ato lokale, nuk mund të punësohet apo shkarkohet person në institucionet shtetërore dhe publike.

Antikorrupsionerët nxorën njëzëri përfundimin se Zvërlevski nuk duhet të ndryshohet në kohën kur janë shpallur zgjedhjet, sepse kjo është shkelje e Kodit Zgjedhor.

Njëkohësisht, mendimi i tyre është dorëzuar te Komisioni i Kuvendit menjëherë pas përfundimit të seancës së komisionit. Sipas Kryetarit të Komisionit, Igor Tanturovski, mendimi i tillë është identik me atë që si Komision deri më tani është deklaruar për raste të ngjashme, kurse në përputhje me nenin 8 të Kodit Zgjedhor që është i qartë.

Antikorrupsionerët deklaruan se një javë pasi VMRO DPMNE kërkoi prej tyre të japin interpretim për zbatim të nenit 8, sipas të cilit gjatë kohës së shpalljes së zgjedhjeve ndalohen procedurat për punësim të personave të rinj apo për përfundim të marrëdhënieve të punës për funksionarët shtetërore.

Partia opozitare kërkoi që të ndalohet diskutimi për shkarkim të Zvërlevskit, derisa Komisioni të japë deklaratë.<sup>12</sup>

Në lidhje me këtë, Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi theksoi se mendimi i Komisionit Shtetëror për Ndalim të Korrupsionit është relevant për diskutimin në Kuvend, dhe Komisioni si pjesë e pushtetit ekzekutiv nuk mund të japë rekomandime për pushtetin ligjvënës.<sup>13</sup>

## **III TË DREJTAT THEMELORE**

### **Liria e shprehjes dhe pluralizmit në media**

Gjatë muajit gusht, dhuna mbi punëtorët në media vazhdoi me rastin e sulmit mbi ekipin e gazetarëve të “NOVA TV” si dhe me incidentin me ekipin e portalit në internet “Kurir”. Domethënë, në rastin e dytë bëhet fjalë për largim të xhiruesit të “Kurir” gjatë seancës publike të Komisionit Shtetëror Zgjedhor.

Në ngjarjen e parë që ka ndodhur më 23 gusht nga një person në QT “Biser” është sulmuar ekipi i gazetarëve të “NOVA TV”, ku bëhej fjalë për targetim të mediave “armike politike” dhe duke dhënë rezistencë ndaj punëtorëve në media të cilat punojnë në drejtim të informimit të publikut. Në lidhje me këtë rast Prokuroria Themelore Publike – Shkup formoi lëndë, kurse nga prokurori i emëruar janë lëshuar

<sup>11</sup><http://www.libertas.mk/antikoruptionska-povede-postapki-za-di/>

<sup>12</sup><https://vistina.mk/?p=522568>

<sup>13</sup><http://vecer.mk/makedonija/antikoruptionska-razreshuvanjeto-na-zvrlevski-bi-bilo-nezakonsko>



urdhra dhe drejtime të cilat kanë për qëllim përcaktimin e identitetit të kryerësit dhe ndriçimin e tërësishëm të ngjarjes, ndërsa më pas do të vijojë vendimi meritor i prokurorisë publike.<sup>14</sup>

Me rastin e këtij sulmi, Ministria e Punëve të Brendshme theksoi se mbetet “e vendosur në qëllimin që të përfundojë praktika e mëparshme e sulmit të padënuar dhe pengimit të gazetarëve në kryerjen e detyrave të tyre të punës”. SPB Shkup pas masave dhe aktiviteteve të ndërmarra në lidhje me këtë ngjarje e ka përcaktuar identitetin e sulmuesit. Kështu, është konstatuar se bëhet fjalë për A.B. (38) nga Shkupi i cili së pari e ka sulmuar njërin gazetar (me sjellje të dhunshme, hedhje të telefonit me të cilin ka xhiruar dhe me tërheqje dhe përdredhje të dorës), kurse pastaj edhe gazetari tjetër, përkatësisht xhiruesin (duke e goditur kamerën me të cilën ka xhiruar), ndërkohë që ata kanë qenë në detyrë zyrtare – mbulim të evenimentit të iniciativës zyrtare për mbledhje të nënshkrimeve kundër ndërtimit të kampeve për migrantët. Kundër personit, siç theksuan nga MPB-ja – do të ngrihet shkresë përkatëse te PTHP Shkup, kurse në lidhje me dyshimin e bazuar për kryerje të veprës penale “dhunë”.<sup>15</sup>

Përveç dënimit për këtë eveniment të sulmit mbi ekipin e gazetarëve të “NOVA TV” nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, gjykim për këtë edhe për incidentin me xhiruesin e “Kurir” erdhi edhe Agjencia Mediatike për Shërbime Audio dhe Audiovizuale (AMSHAAV).<sup>16</sup>

AMSHAAV përveç aktiviteteve të tjera, filloi edhe me monitorimin e informimit të radiodifuzerëve për zgjedhjet lokale 2017, kështu që të gjithë radiodifuzerëve është dërguar shkresë ku informohen saktësisht mbi obligimet e Kodit Zgjedhor të cilat duhet t’i përmbushin deri në fillim të fushatës zgjedhore, kurse për këtë qëllim është informuar se do të mbahen edhe trajnime të veçanta. Nga AMSHAAV-ja rikujtuam edhe se nga dita e shpalljes së zgjedhjeve rrjedh afati prej pesë ditësh, ku të gjitha stacionet televizive dhe radio të cilat emitojnë reklamim politik me pagesë gjatë fushatës zgjedhore, duhet t’i përcaktojnë dhe dorëzojnë listat e çmimeve tek Agjencia, te Komisioni Shtetëror Zgjedhor, tek Enti Shtetëror i Revizionit dhe te Komisioni Shtetëror për Pengim të Korrupsionit.

Më 22 gusht 2017 është shpallur edhe Raporti i parë i monitorimit të informimit në media për zgjedhjet lokale për periudhën 7 deri më 16 gusht 2017, i cili dëshmoi se radiodifuzerët, në lajme, i respektojnë në përgjithësi standardet gazetares profesionale. “Te shumica e mediave është vënë re këmbëngulja që të sigurohen qëndrime të shumëllojshme për çështje dhe tema për të cilat përpunohen. Përgjithësisht bëjnë një numër i vogël mediash të cilat mund të vihet re tendenca për transmetim të qëndrimeve të subjektit të cilat kanë të njëjtën pozitë për tema të caktuara.”<sup>17</sup>

<sup>14</sup><http://www.pravdiko.mk/ojo-skopje-postapuva-za-rasvetluvane-na-napadot-vrz-ekipata-na-nova-tv/>

<sup>15</sup><http://www.mvr.gov.mk/vest/4629>

<sup>16</sup>[http://www.avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3343%3A2017-08-17-14-10-38&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk;](http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3343%3A2017-08-17-14-10-38&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk;)  
[http://www.avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3350%3A2017-08-24-13-05-24&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk](http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3350%3A2017-08-24-13-05-24&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk)

<sup>17</sup>[http://www.avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3349%3A-2017-&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk](http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3349%3A-2017-&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk); Raporti i lajmërimit të mediave mund të shihet këtu: [http://www.avmu.mk/images/lzvestaj\\_od\\_monitoring\\_7-16\\_avgust\\_2017.pdf](http://www.avmu.mk/images/lzvestaj_od_monitoring_7-16_avgust_2017.pdf)



## Avokati i Popullit

Duke pasur parasysh se gjatë gushtit u shpallën zgjedhjet lokale, shumica e institucioneve të sistemit u angazhuan me monitorimin e procesit parazgjedhor dhe zgjedhor.

Avokati i Popullit z. Memeti informoi se është përmirësuar mjaft komunikimi i organeve dhe institucioneve të cilat monitorohen nga zyra e tij, por edhe përkrah ndryshimeve ligjore të kryera për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe mosharmonizimit të normativës ligjore, është pamundësuar zbatimi i tyre praktik.

Avokati i Popullit në këtë drejtim është ankuar sidomos te Misioni i OSBE-së në Republikën e Maqedonisë se nuk ka mjete të mjaftueshme për zbatimin e monitorimit. Ai theksoi se për shkak të mungesës së kuadrit është vënë në pikëpyetje monitorimi i procesit zgjedhor, si dhe hapja e linjës telefonike pa pagesë për zgjedhjet e ardhshme lokale.<sup>18</sup>

## Diskriminimi

Shpallja e ekipit të Maratonës 31 ndërkombëtare të atletikës në rrjetet sociale, e cila lidhet me shpërblimin për pjesëmarrësit dhe shumata e ndryshme mbi faktin se a janë fitimtarët burra apo gra<sup>19</sup>, ka shkaktuar reagime të shumta në publik. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë reagoi ndaj këtij vendimit të Maratonës internacionale të atletikës Ohër fondet shpërblyese për atletët të jenë përafërsisht dy herë më të larta se ato të atleteve. Kjo është karakterizuar si rast klasik i diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë që është në kundërshtim me parimet e garave sportive, përkatësisht sigurimit të barazisë për pjesëmarrësit.<sup>20</sup>

Pas reagimeve, nga ekipi i Maratonës ndërkombëtare të atletikës kërkuan falje, si dhe vijuan korrigjime për shumata shpërblyese të cilat u barazuan edhe për pjesëmarrësit femra dhe meshkuj.

<sup>18</sup><http://sdk.mk/index.php/makedonija/narodniot-pravobranitel-se-pozhali-na-obse-deka-nema-pari-za-monitoring-na-lokalnite-izbori/>

<sup>19</sup><https://www.facebook.com/reflektor.mk/photos/a.1322313007845255.1073741828.1322190011190888/1420319931377895/?type=3&theater>

<sup>20</sup>[http://mhc.org.mk/announcements/620?locale=mk#.Wa\\_CH1EjHIU](http://mhc.org.mk/announcements/620?locale=mk#.Wa_CH1EjHIU)